



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## PROKURORIA PRANE GJYKATËS SË APELIT TIRANË

### *Analizë vjetore mbi punën e Prokurisë së Apelit Tiranë për vitin 2016*

Të nderuar kolegë,

Analiza e punës së Prokurorisë së Apelit Tiranë për vitin 2016, zhvillohet sot nën dritën e ndryshimeve thelbësore që shoqërojnë sitemin e drejtësisë në vendin tonë. Miratimi i ndryshimeve kushtetuese, për reformimin e sistemit të drejtësisë kanë në fokusin e tyre, angazhimin maksimal të të gjithë faktorëve dhe aktorëve në vend, por mbi të gjitha angazhimin e drejtëpërdrejt të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të rikthyer besimin e publikut tek drejtësia, ku forca e ligjit vlen për të gjithë në mënyrë të barabartë, në përmbushje dhe respekt të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndërtimi i shtetit ligjor dhe demokracisë, kërkon në radhë të parë krijimin e një sistemi drejtësie të besueshëm, të paanshëm, të përgjegjshëm dhe eficient, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt një shërbimi transparent ndaj publikut. Gjithashtu, goditja e krimit të organizuar në të gjitha format e tij, intesifikimi i luftës kundër terrorizmit dhe krimit ndërkombëtar, lufta kundër korrupsionit, në respekt të plotë të Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, si dhe të gjitha angazhimet ndërkombëtarë të ndërmarra ndaj

partnerëve tanë, BE dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës përbëjnë sot, sfidat kryesore me të cilat përballet shoqëria shqiptare e në veçanti sistemi i drejtësisë.

Në këtë kuadër, përmbushja e detyrave dhe angazhimeve kërkon bashkërendim dhe bashkëpunim të ngushtë institucional nga të gjithë institucionet ligjzbatuese të shtetit. Në vijim, është kërkuar dhe kërkohet vazhdimisht, rritja e rolit të prokurorit dhe, shkëmbimi i informacionit dhe dokumentimit të veprave penale, si dhe rritje të kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore.

Sot, bilancin e punës së vitit që lamë pas, e bëjmë në një kohë kur ndryshimet kushtetuese për reformën në drejtësi kanë marrë udhë, si dhe paketa ligjore që i shoqëron ato po miratohet në vijëmbësi. Padyshim, që kjo analizë vjetore është një çështje që kërkon vëmendjen e duhur, për të analizuar të gjithë komponentët përbërës të punës sonë, me treguesit pozitivë, por edhe problematikat e hasura, si dhe sfidat e mëdha, që na presin në kuadër të reformimit rrënjësor të sistemit të drejtësisë.

Më lejoni që nëpërmjet kësaj analize treguesish, të parashtroj përpara jush në mënyrë të përmbledhur arritjet e institucionit tonë për vitin 2016.

Në përmbushjen e detyrës sonë, gjithsecili nga ne është mbështetur në parimin kushtetues të ushtrimit të ndjekjes penale dhe respektimit të parimeve të sanksionuara në ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Ushtrimi i kompetencave, duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të

ligjshme të njeriut, si dhe interes publik do të jetë gjithnjë motoja e punës sonë.

Në këtë kontekst, të gjithë prokurorët e Apelit kanë dhënë kontributin e tyre në kryerjen me përgjegjshmëri të detyrave dhe përfaqësimin e akuzës në gjykatë. Qëllimi ynë gjatë këtij viti ka qenë përmirësimi i preformancës në përfaqësim dhe rritja e efikasitetit në gjykimin e çështjeve. Gjatë vitit që lamë pas ka patur një rritje të numrit të çështjeve të themelit të përfaqësuara në Gjykatën e Apelit, punë që është përballuar pa bërë shtyrje fiktive të seancave gjyqësore.

Prokuroria e Apelit Tiranë, për nga numri dhe rëndësia e çështjeve të përfaqësuara ka mbuluar gjithnjë volumin më të madh, përse i përket gjykimin në shkallë të dytë. Për këtë, do të vlerësoja punën e të gjithë prokurorëve, që me përkushtimin e tyre kanë përballuar këtë ngarkesë të konsiderueshme.

Për përballimin e këtij volumi pune, rol të rëndësishëm ka luajtur administrata mbështetëse dhe financa pranë prokurorisë sonë, e cila në të gjitha hallkat përbërëse ka asistuar dhe ndihmuar prokurorët në kryerjen e detyrës.

Gjithashtu, e rëndësishme është të theksohet edhe marrëdhëniet korrekte që kemi me gjykatën e Apelit, e cila na ka krijuar kushtet për realizimin e punës sonë. Bashkëpunimi i frytshëm me titullarin e këtij institucioni, trupën e gjyqtarëve dhe administratën gjyqësore, ka bërë të mundur vënien në dispozicion të të gjitha materialeve dhe akteve të nevojshme dhe në kohë reale.

Më poshtë pasqyrojmë të dhënat statistikore për punën e realizuar nga prokurorët, për vitin 2016.

Analiza konkrete e treguesve të punës për vitin 2016, bazuar në të dhëna të sakta, do të nxjerrë në pah më mirë rezultatet e punës tonë.

Prokuroria e Apelit Tiranë, ka përfaqësuar në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, *1895 çështje penale në themel, me 2227 të pandehur*. Duke krahasuar numrin e çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë me *vitin 2015*, ku janë gjykuar *2227 çështje penale në themel, me 2656 të pandehur* numri i çështjeve ka një ulje te vogël .

Për sa i përket masave të sigurimit në Gjykatën e Apelit, janë gjykuar *2024 masa sigurimi personal*. Krahasuar me *vitin 2015*, ku janë gjykuar *1970 masa sigurimi personal, ka rritje prej 54 çështje ose 3 % të çështjeve*.

Për sa i përket **masave të sigurimit** rritja e numrit ka disa arsye:

1. Në këtë numër çështjesh, rreth 419 çështje janë shuarje mase sigurimi për efekt të mbarimit të afateve të masës së dënimit dhënë në shkallë të parë, gjatë kohës që çështja ka qenë pa u gjykuar në Gjykatën e Apelit. Kjo e dhënë na bën të reflektojmë, që në bashkëpunim me Gjykatën e Apelit të ulim kohën e gjyqimit nga shkalla e parë në apel, nëpërmjet gjykimeve të shpejta.
2. Rritja e numrit të çështjeve për masa të sigurimit personal vjen si pasojë e rritjes së numrit të çështjeve të regjistruara me persona të arrestuar apo të ndaluar.

3. Vihet re, që rritja ka ardhur edhe si pasojë e mungesës së një praktike të unifikuar si nga Gjykatat dhe nga Prokuroritë e shkallëve të para, për të njëjtën kategori veprash penale, sidomos të atyre me rrezikshmëri jo të lartë shoqerore.
4. Konstatohet me keqardhje një numër i madh i të masave të sigurimit për personat që janë minorenë, kryesisht nxënës shkollash, të cilët kryejnë vepra penale në fushën e narkotikëve apo të vjedhjeve. Për këtë kategori personash masa e izolimit në institucion është marrë vetëm në rastet ekstreme kur asnjë masë tjetër nuk ka qenë e përshtatshme.

Nga ana jonë, përgjithësisht janë mbështetur vendimet e gjykatave sipas kërkesës së prokurorit dhe apelet e prokurorëve për masat e sigurimit, pasi në mazhorancë, masa e sigurimit "Arrest në burg", është vendosur me të drejtë për vepra penale dhe persona nën hetim me rrezikshmëri të lartë shoqerore.

Prokurorët i kanë kushtuar kujdes të veçantë studimit të çështjeve të themelit, për t'u përfaqësuar me cilësi në gjyq. Për çështjet më problematike, me shumë të pandehur dhe për akuza të rënda janë bërë analiza në Këshillin e Prokurorisë, para përfaqësimit në gjyq. Për sa i përket çështjeve të themelit, kanë ardhur dhe janë gjykuar, mbi *apelin e prokurorit 569 çështje ose 30 %* dhe mbi *ankimin e të pandehurve 1326 çështje ose 70 % të rasteve*. Ndërsa, për sa i përket *masave të sigurimit në 2024 raste, 449 raste* kanë ardhur në Prokurorinë e Apelit *mbi bazën e apelit te Prokurorit ose 22% dhe në 1575 raste* kanë ardhur mbi *ankimin e të pandehurve ose 78 %*.

Rëndësi të veçantë në punën e prokurorëve ka patur studimi i apeleve të prokurorëve. Kështu, **569 çështje** janë mbi apelin e prokurorit. Nga këto, nga prokurorët e apelit, nuk janë mbështetur **221 apele ose 38.8%**. Këto çështje janë diskutuar me prokurorët që kanë përfaqësuar çështjen, në zbatim edhe të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi të drejtën e ushtrimit me eficensë të ankimit. Bëjmë me dije, se për një pjesë të apeleve nga ana e prokurorëve, është kërkuar pushimi i çështjeve për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit për dhënie amnistie.

Prokurorët kanë përkrahur apelet në shumicën e rasteve. Për çështje themeli, Gjykata e Apelit Tiranë, **nga 348 apele të përkrahura nga prokurori, ka pranuar apelet e prokurorit në 62 raste ose rreth 17.8 %**.

**Në 1448 raste**, nga prokurorët e apelit, është kërkuar lënia në fuqi e vendimit. Nga këto, Gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit **në 1204 raste ose 83%**. Nga 1792 çështje të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, janë pranuar konkluzionet e prokurorëve për 1262 çështje ose e shprehur në përqindje **70.4 %**. Ka një rritje të vogël krahasuar me vitin 2016.

Gjatë vitit 2016 janë pushuar çështjet në 21 raste.

Sipas rretheve, apelet janë të shpërndara si më poshtë:

- a) Tirana ka 482 apele, janë përkrahur nga Prokurori 284 apele dhe është hequr dorë në 198 raste, ndërsa gjykata ka pranuar apele 42;
- b) Kruja ka 10 apele, janë hequr dorë nga apelet në 4 raste, janë përkrahur 6 apele nga Prokurori. Gjykata e Apelit ka pranuar 2 apele;

c) Kurbini ka 22 apele, është hequr dorë në 3 raste dhe janë përkrahur 19 raste, ndërsa Gjykata ka pranuar 6 apele;

ç) Dibra ka 29 apele, janë hequr dorë nga apeli në 9 raste, janë përkrahur 20 apele, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë ka pranuar 5 apele;

d) Mati ka 26 apele, janë hequr dorë në 7 raste, janë përkrahur 19 apele dhe Gjykata ka pranuar vetëm 3 apele.

Nga pasqyra e këtyre treguesve vihet re, se nuk janë përkrahur apelet për masa dënimi, ku diferenca ka qenë e vogël dhe për vepra penale me rrezikshmëri të vogël shoqërore të veprës apo të personit nën hetim. Qëndrim ligjor është mbajtur nga ana jonë për çështjet penale të cilat kanë marrë pafajsi, duke mbështetur apelet e prokurorit në të shumtën e rasteve. Nga treguesit rezulton se vitin e kaluar janë apeluar nga prokurorët 94 vendime pafajsie. Janë mbështetur ankimet në 68 raste dhe Gjykata e Apelit ka pranuar ankimin në 17 raste, pra rreth 18% të vendimeve.

*Në 1326 raste*, çështja ka ardhur në Gjykatën e Apelit Tiranë, mbi bazën e ankimit të të pandehurit. *Në 17 raste ose 0,9 %*, është kërkuar prishja e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe është dërguar çështja për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë. Të njëjtën linjë ka mbajtur dhe Gjykata e Apelit Tiranë, ku ka prishur dhe kthyer për rigjykim 17 çështje. Theksojmë, se në të gjitha këto çështje Gjykata e Apelit, ka pranuar kërkesën tonë, pasi janë konstatuar shkelje të rënda procedurale në gjykimin në shkallë të parë.

Në 21 raste ose 1,1 % është kërkuar nga ana jonë pushimi i çështjes për efekt të amnistisë dhe me të drejtë është pranuar nga Gjykata.

Për sa i perket çështjeve të themelit nga ana e prokurorit është kërkuar lehtësimi i pozitës së të pandehurit me 65 raste:

Për çështjet e themelit, Prokurori ka kërkuar lehtësim pozite në 65 raste dhe pushim çështje në 21 raste. Sipas prokurorëve është shprehur sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Prokurori	Lehtësuar pozita	Pushuar Çështja
1	Altin Dumani	10	5
2	Dritan Peka	2	
3	Edi Hyka	8	5
4	Gentian Trenova	-	-
5	Genti Xholi	10	5
6	Luan Kaloçi	22	2
7	Nezir Gjoka	2	1
8	A.Qosja	7	1
9	F.Memçaj	4	2
	Total	65	21

*Në 1448 raste*, nga prokurorët e apelit është kërkuar lënia në fuqi e vendimit. Nga këto, Gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit në *1204 ose raste ose 83.1%* , ka lehtësuar pozitën në *192 raste ose 13.3 %*,



ka pushuar çështjen në 28 raste ose 1,9 % dhe ka kthyer për rigjykim 24 raste ose 1,6%.

Nga këto tregues, vihet re se janë prishur dhe kthyer për rigjykim 24 çështje, për shkak të shkeljeve procedurale në gjykim në shkallë të pare dhe në respektim të Vendimeve Unifikuese të Gjykatës së Lartë për një proces të rregullt e ligjor.

Është lehtësuar pozita e të pandehurit në 65 raste. Por, ka të bëjë kryesisht me veprat penale të “drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”, me ulje të vogla të masave të dënimit ose aplikimit brenda kriterëve ligjore të nenit 59 të K.Penal, si dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, si rezultat i Vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ndryshimit që i është bërë kësaj dispozite në Kodin Penal. Në të gjitha rastet kur është dhënë pafajësi ose janë pushuar akuzat, nga ana jonë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga ana jonë është kërkuar përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në disa çështje, por në masën më të madhe nuk është pranuar. Kjo mbetet një prioritet në marrëdhënie me gjykatën, pasi do ta bënte gjykimin në apel të plotë e objektiv dhe, do të ulte numrin e çështjeve që prishen dhe kthehen nga Gjykata e Apelit për rigjykim.

Për sa i përket shpërndarjes së çështjeve sipas veprave penale ato paraqiten si më poshtë:

Neni 137 i K.Penal, janë gjykuar 372 çështje, me 377 të pandehur, me 27 të arrestuar;

Neni 134 i K.Penal, janë gjykuar 160 çështje, me 225 të pandehur, me 137 të arrestuar.

Neni 278/2 i K.Penal, janë gjykuar 68 çështje, me 79 të pandehur, 68 të arrestuar.

Neni 279 i K.Penal , janë gjykuar 17 çështje, me 18 të pandehur, 14 të arrestuar

Neni 283 i K.Penal, me 58 çështje, 72 të pandehur, 63 të arrestuar.

Neni 290 i K.Penal, me 36 çështje, me 36 të pandehur, 19 të arrestuar.

Neni 291 i K.Penal, me 212 çështje, me 212 të pandehur, 8 të arrestuar

Neni 186 i K.Penal, me 23 çështje, me 40 të pandehur, 8 të arrestuar

Neni 189 i K.Penal, me 12 çështje, me 12 të pandehur, 2 të arrestuar

Neni 143 i K.Penal, me 47 çështje, me 50 të pandehur, 16 të arrestuar

Neni 139 i K.Penal, 21 çështje, me 28 të pandehur, 24 të arrestuar

Neni 236 i K.Penal 26 çështje me 40 te pandehur 7 te arrestuar.

Neni 135 i K.Penal, 12 çështje, me 18 të pandehur, 3 të arrestuar

Neni 140 i K.Penal, 5 çështje, me 10 të pandehur, 10 të arrestuar

Po kështu, vepra penale e vjedhjes mbetet në vite me tregues të lartë. Gjithashtu, vërehet një rritje e numrit të veprave penale në fushën

e vjedhjes së energjise elektrike dhe Drejtimit të mjeteve në mënyre të parregullt.

Nga numri i çështjeve në tërësi, Tirana zë numrin më të madh të çështjeve të gjykuara, 1619 çështje ose 85.4 %, më pas vjen Dibra me 83 çështje ose 4,4 % të çështjeve, Mat me 68 çështje ose 3,6%, Kurbini me 63 çështje ose 3,3 % dhe Kruja me 62 çështje ose 3,2 %.

Më poshtë po ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur ngarkesën e prokurorëve:

*Për Çështje Themeli*

Nr.	Prokurori	Çështje	Apele	Apel te pand	Pr.Apeli	H.Dore	Pr.Apeli Gjykata	Rekurse
1	Dritan Peka	95	22	73	6	16		-
2	Edmond Hyka	263	84	179	47	37	6	36
3	Nezir Gjoka	261	80	181	66	14	12	41
5	Genti Xholi	254	87	167	63	24	12	34
7	Gentian Trenova	24		24				-
8	Fatjona Memçaj	180	56	124	37	19	6	12
9	Altin Dumani	279	83	196	41	42	10	26

10	Arben Qosja	261	68	193	47	21	5	34
11	Luan Kaloci	277	89	188	41	48	7	20
12	Gjergji Tako me autorizim	1		1			-	-
	Total	1895	569	1326	348	221	58	203

Përsa i përket masave të sigurimit kanë ardhur mbi Apelin e Prokurorit 449 raste ose 22.2% të rasteve. Nga ana e prokurorëve është hequr dorë ose mospranuar apeli i prokurorit në 213 raste ose 47.4 % .

Kryesisht, nuk kemi përkrahur apelin e prokurorit, për “Arrest në burg”, pasi i kemi konsideruar vendimet e gjykatave të shkallëve të para të drejta. Këto masa (234, 237 të K.Pr.Penale) janë aplikuar për të mitur, nxënës apo studentë, për vepra penale me rrezikshmëri shoqërore të ulët, për vepra penale, të cilat janë inicuar me ankimin e të dëmtuarve.

Edhe pranimi nga Gjykata i apeleve për masat e sigurimit për vitin 2016 është e ulët. Kështu, nga 236 apele të përkrahur nga prokurori, Gjykata e Apelit ka pranuar në 35 apele ose rreth 14.8% të apeleve, me një rritje të vogël krahasuar me vitin 2015. Ky tregues mendojmë se ka ardhur si pasojë e aplikimit nga gjykatat e shkallëve të para, jashtë kriterëve ligjore të masës së sigurimit “Arrest në burg”, siç e kemi përmendur edhe më lart dhe, me arsyet përkatëse.

Ndërsa, për masa sigurimi apelet sipas rretheve janë:

a) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka 368 apele, është hequr dorë nga apeli në 185 raste, janë pranuar 183 raste dhe Gjykata ka pranuar 25 raste ose 13.7 %.

b) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër, ka 19 apele, është hequr dorë nga apeli në 9 raste, janë përkrahur 10 apele, Gjykata ka pranuar 2 apele ose 2%.

c) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë, ka 13 apele është hequr dorë në 7 raste, janë përkrahur 6 apele, Gjykata e Apelit Tiranë ka pranuar 1 apel ose 1.7.%

ç) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ka 36 apele, janë përkeahur 27 apele, është hequr dorë në 9 raste, Gjykata ka pranuar 5 apele ose 18.5 %

d) Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat ka 13 apele, është hequr dorë nga apeli në 3 raste, janë përkrahur 10 apele, Gjykata ka pranuar 2 apele ose 2%.

Përsa i përket masave të sigurimit, Tirana ka 1716 çështje ose 84.8 % të çështjeve, Dibra 71 çështje ose 3,5 %, Kurbin 101 çështje ose 4.99 %, Kruja 86 çështje ose 4,2 %, dhe Mati me 49 çështje ose 2,4 %.

Nga ana jonë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë në 310 raste. Nga këto, *çështje themeli* 203 dhe *masa sigurimi* 107. Nga ky tregues del qartë, se kemi rekursuar një numër të madh çështjesh, për mendimin tonë brenda kriterëve ligjore. Megjithëse, nuk kemi të dhëna të plota për mënyrën e përfundimit. Mbetet domosdoshmëri zgjerimi i objektit të rekursit në Gjykatën e Lartë me anë të ndyshimit të K.Pr.Penale.

Përsa i përket masave të sigurimit, nga ana e prokurorëve është kërkuar miratimi i vendimit në 1290 raste, nga ana e gjykatës është miratuar vendimi në 1122 raste ose rreth 87 % dhe është ndryshuar vendimi në 163 raste ose 12,6 % dhe në 5 raste është vendosur shfuqizimi i vendimit ose 0,4% .

Në 126 raste ose 6,2 %, nga ana e prokurorëve është kërkuar ndryshimi i masës së sigurimit, kërkesë kjo e pranuar nga gjykata në përputhje edhe me Kodin e Procedurës Penale.

Në Gjykatën e Apelit gjatë vitit të kaluar, janë gjykuar 419 çështje me objekt shuarje masë sigurimi, ku në 402 raste, nga prokurori është kërkuar shuarja e masës së sigurimit, po kështu ka vendosur dhe gjykata. Në 17 raste për shuarje masë sigurimi është kërkuar rrëzimi i kërkesës, për faktin se i pandehuri nuk e kishte vuajtur dënimin e dhënë nga gjykata ose është kërkuar moskompetenca. Të njëjtën gjë ka vendosur edhe Gjykata.

Shkaqet që prokurorët kanë kërkuar ndryshimin e masës së sigurimit në një masë sigurimi më të butë kanë konsistuar në:

- Ndryshimin e kushteteve, rrethanave dhe kriterëve ligjore të vendosjes së tyre në Gjykatën e Shkallës së Parë, në kohën kur kjo masë është gjykuar në Gjykatën e Apelit.

- Faktit i është dhënë një kualifikim ligjor për një vepër penale më të lehtë se ajo që është arrestuar në fillim.

- Është ndryshuar masa e sigurimit, nga arrest në burg, në masa sigurimi më të lehta për të miturit, që akuzohen për vepra penale të

lehta (vjedhje në sasira tepër të vogla, përdorimi dhe mbatja në sasira të vogla e lëndëve narkotike të tipit canabis sativa, etj.), të cilat për nga sasia e vogël dhe rrethanat e çështjeve konkrete, krijohej bindja se këto çështje shkonin drejt pushimit të çështjes.

-Kanë ndryshuar kushtet dhe kriteret e vendosjes së masave të sigurimit, në kuptim të nenit 260 të K.Pr.Penale.

Nga ana e Prokurorëve në Prokurorinë e Apelit Tiranë, është përballuar një volum i madh pune në studimin, përgatitjen e materialeve dhe përfaqësimin e çështjeve në gjyq për masa sigurimi. Siç u përmend dhe më lart, prokurorët në Prokurorinë e Apelit Tiranë janë përfaqësuar në Gjykatë në 1970 çështje për masa sigurimi personal e konkretisht:

*Për masa sigurimi*

Nr	Prokurori	Shuarje mase	masa	Total masa	Apele prok	Pr.Ap	H.Dore	Pranuar Gjykata	Nd. Masa	Rekurse
1	D.Peka	-								-
2	A.Dumani	57	180	237	50	18	32	4	5	13
3	A.Qosja	35	187	222	56	30	26	8	6	10
4	E.Hyka	63	233	296	68	35	33	4	27	9
5	F.Memçaj	44	231	275	39	22	17	2	11	14
7	G.Xholi	54	244	298	75	46	29	6	14	23

8	N.Gjoka	49	163	212	57	48	9	6	6	32
9	G.Ternova	1	15	16	5	1	4		1	-
10	L.Kaloçi	115	352	467	99	36	63	5	56	6
11	Gj.Tako	1	-	1						-
	Total	419	1605	2024	449	236	213	35	126	107

Shpërndarja e çështjeve penale, sipas veprave penale për masa sigurimi është si mëposhtë:

Vepra penale e vjedhjes, sipas nenit 134 me 162 çështje me 162 të pandehur, neni 291 me 165 çështje me 165 të pandehur, neni 137 me 62 çështje me 62 të pandehur, neni 278 me 56 çështje, me 56 të pandehur, neni 283 me 201 çështje, me 201 të pandehur, neni 248 me 39 çështje, me 39 të pandehur, neni 139, 27 çështje, me 27 të pandehur, neni 290, 66 çështje, me 66 të pandehur, neni 236, me 30 çështje, me 30 të pandehur, neni 143, me 29 çështje, me 29 të pandehur, neni 130, me 193 çështje, me 193 të pandehur.

Po kështu, në vitin 2016 janë ekzekutuar 916 urdhëra ekzekutimi. Në zbatimin e urdhërave të ekzekutimit është mbajtur parasysh ekzekutimi i tyre në kohë sa më të shpejtë sipas ligjit për ekzekutimet e vendimeve penale dhe të Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Për vitin 2016, janë përgatitur dhe arshivuar të gjitha minidosjet e çështjeve të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, në të cilën ruhen akte



të tilla si: konkluzione të prokurorit të shkallës së parë, vendimi i gjykatës shkallës së parë, ankimet e prokurorit ose të të pandehurit, konkluzionet e prokurorit dhe vendimi i Gjykatës se Apelit, aktet e administruara në rastet, kur ka patur çelje të shqyrtimit gjyqësor dhe administrim të provave, si dhe rekursitet e ushtruara.

Rezultatet e arritura deri tani nga ana jonë për vitin 2016, kanë ardhur falë bashkëpunimit me drejtuesit dhe prokurorët e prokurorive të shkallëve të para që mbulon Prokuroria e Apelit Tiranë, si dhe diskutimi me Drejtorinë Gjyqësore dhe atë të Marëdhënieve me Jashtë për çështje të komplikuara dhe problematike.

Vlen të theksojmë gjithashtu, se rezultatet e Prokurorisë së Apelit Tiranë, gjatë vitit 2016, kanë ardhur edhe si rezultat i rritjes së bashkëpunimit ligjor të vendosur me Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe me kryetarin e kësaj gjykate z. Hysni Demiraj. Kushtet e punës janë përmirësuar, pasi tani gjyqet (seancat gjyqësore) zhvillohen me regjistrim audio, dosjet vijnë nga gjykata në kohën e duhur për t'u studiuar nga ana jonë, zhvillimi i gjykimit bëhet brenda etikës së seancës gjyqësore, rritja e transparencës së gjykimeve, duke ngarkuar në faqen zyrtare të gjykatës në internet, listat e gjyqeve dhe vendimet, përmirësimi i kushteve të sallave të zhvillimit të gjyqeve në Gjykatën e Apelit.

**Vizioni, synimet që kërkohen të arrihen dhe përmirësimet në punën tonë, për vitin 2017**

Nisur nga problematikat e hasura në praktikë, së pari, do të përqëndrohemi në cilësinë e përfaqësimit të prokurorëve.

Gjatë vitit që lamë pas, konstatohet dukshëm rritje e cilësisë në hartimin e akteve nga ana e prokurorëve, si në konkluzionet përfundimtare, ashtu edhe në rekursat e ushtruara. Aktet e hartuara nga prokurorët e Apelit, jo vetëm kanë qenë në përputhje me kriteret ligjore, por të shoqëruara përgjithësisht, me arsyetime të hollësishme ligjore dhe analizë të detajuar të provave, tej apeleve të shkallës së parë. Është synuar, që konkluzionet përfundimtare apo rekursat, të strukturohen mbi bazën e “një akti model”, për të krijuar hapësirën e nevojshme, për përfshirjen dhe respektimin me rigorozitet të të gjitha elementëve dhe bazës ligjore, që duhet të përmbajnë ato. Gjithsesi, rritja e performancës së përfaqësimit në Gjykatë është dhe mbetet sfida e gjithsecilit, pasi asnjëherë nuk mund të themi që kemi arritur më të mirën dhe, në këtë drejtim, mbetet shumë për të bërë.

Së dyti, do të ritheksojmë problemin e përvitshëm, përqindjen jo të kënaqshme të apeleve dhe rekurseve të fituara në gjykatë. Gjatë këtij viti, është punuar seriozisht në drejtim të rritjes së efikasitetit të përfaqësimit, duke shtuar heqjet dorë nga ankimi për masa dënimi të ulëta dhe duke mbështetur me rigorozitet apelet, ku ngrihen probleme të vendimeve të gjykatës. Kështu, numri i apeleve të fituara është rritur dhe numri i vendimeve të ndryshuara mbi ankimin e të pandehurit ka një ulje të lehtë. Por, mendoj që për rritjen e efikasitetit të përfaqësimit lind nevoja e rritjes së bashkëpunimit me prokurorët e shkallës së parë. Kjo, me qëllim unifikimin e rasteve kur do të ankimohen vendimet e gjykatës, në lidhje me alternativat e dënimit me burgim, caktimin e masave të dënimit apo të masave të sigurimit, për veprat penale me rrezikshmeri të ulët, të cilat shënojnë shumicën e çështjeve të humbura nga

prokuroria. Nga shifrat e pasqyruara rezultoi se, shumica e gjykimeve ishte për dispozitat që përbëjnë dhe veprat penale më të frekuentuara, pra nenet 134, 137, 139, 236, 291 të K.Penal. Gjithashtu, është e qartë që numri i çështjeve të gjykuara në shkallë të parë për këto vepra, është shumë më i madh se numri i çështjeve të ankimuar, pra, jo gjithnjë vendimi i gjykatës ankimohet nga prokurori, megjithë mospërputhjen e vendimit me kërkesën e akuzës. Por, mendoj që rritja e bashkëpunimit në të tre shkallët e prokurorisë, për shkak të misionit të akuzës, që është lufta ndaj kriminalitetit, do të sillte rritje të efikasitetit të përfaqësimit në Gjykatë dhe shtimit të numrit të vendimeve, sipas kërkesës së prokurorit.

*Së treti*, në rastet e pafajësive apo ndryshimit të kualifikimit ligjor të veprës penale, shkak kryesor është puna jo e mirë në hetim e policisë gjyqësore. Edhe në gjykimin në Apel, shkak kryesor i humbjes së çështjeve është puna e dobët në hetim. Mosmarrja e provave të nevojshme, apo marrja e provave jo në mënyrën e duhur ligjore, janë shkaqet që bëjnë të vështirë punën e prokurorit në shkallë të dytë, duke mos i dhënë dot provës vlerën duhur.

*Në përfundim*, vlen të theksohet se për këtë vit është bërë një punë e mirë, pavarësisht vështirësive dhe problematikave të hasura. Sfidë kryesore për të ardhmen mbetet përmirësimi i performancës dhe rritja e efikasitetit, duke shtuar numrin e çështjeve të fituara. Sidomos, përsa i përket krimeve në fushën e veprimtarisë shtetërore, ku duhet të shtohen rastet që penalizohen, duke provuar me hetim të gjithanshëm, që nuk kemi të bëjmë me shkelje administrative, sikurse është shpesh përfundimi i vendimeve të gjykatës, si dhe të ashpërsohen masat e

dënimit në këto vepra, me qëllim parandalimin e fenomenit problematik, atë të abuzimit me detyrën shtetërore.

Por, sfida më e madhe mbetet riorganizimi dhe ristrukturimi i institucionit në frymën e ndryshimeve të reja kushtetuese. Zbatimi me korrektësi, përgjegjshmëri dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie i ndryshimeve kushtetuese dhe gjithë paketës ligjore që shoqëron këto ndryshime, është një nga objektivat madhorë të institucionit tonë për vitin në vazhdim. Për këtë po bëhet një punë e konsiderueshme nga Prokuroria e Përgjithshme me qëllim zbatimin praktik të ndryshimeve ligjore, punë e cila duhet të mbështetet nga ana jonë me mendime dhe propozime konkrete, me qëllim përmirsimin e mëtejshëm të punës sonë.

*Ju faleminderit!*

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**Dritan PEKA**